



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:053651  
Datë: 12.11.2024  
Numri i dokumentit: 06437675

C.nr.445/21

GJYKATA THEMELORE Pejë Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtar Vegim Maloku, në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses M.Rr nga P...., të cilën e përfaqëson Esad Muharemi, avokat në P...., kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: pagesa e tre (3) pagave për dalje në pension dhe për shpërblim jubilar, vlera e kontestit: 2,243.00€, jashtë seancës, me datë 12.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses M.Rr nga P...., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ministria e Shëndetësisë-Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës në Prishtinë, në vlerën e pagës bazë prej 373.95€, që paditëses t'ia paguaje tri (3) paga për përcjellje në pension shumë prej 1.121,85€, dhe tri (3) paga në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 1.121,85€, e në shumë të përgjithshme prej 2,243.00€, së bashku me kamatën ligjore nga dita e arritjes së detyrimit për pagës të paditëses, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimit të detyrueshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësja M.Rr nga P...., pranë kësaj gjykate me dt.22.03.20.. ka paraqitur padi, kundër të paditurës, duke bërë plotësimin-precizimin e padisë me datë 25.10.20.., me objekt kontesti kompensimin e pagave për përcjellje në pension dhe për shpërblim jubilar, duke përkrahur gjendjen faktike si në vijim: Paditësja ka qenë marrëdhënie punë që nga data 01.01.2013 gjerë me datën 23.03.20.., ndërsa që nga viti 01.01.20... gjerë me datën 23.03.20.. kishte punuar në Institutin Shëndetit Publik Dega në P... në punët dhe detyrat- pastruese, ku dhe ka fituar të drejtën në pension pleqërisë dhe u pensionua me stazh punës prej (45 vite dhe 3 muaj). Paditësja M.Rr me rastin e pensionimit dhe me stazhin e punës prej 45 vite dhe 3 muaj, e në bazë të nenit. 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës të viti 2015, e njëjta fiton drejtën në shpërblim jubilar në vlerë prej të tri (3) paga mujore (vlera pagës së fundit para pensionimit të saj), dhe po ashtu me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagesën përcjellje në lartësi prej tri (3) paga mujore qo i ka marr për tre muaj të fundit. Nga të lartcekurat paditësja ka interes juridik për të realizuar drejtën ligjore nga marrëdhënia e punës e në bazë të pensionimit dhe stazhit të punës, andaj i autorizuari i paditëses i ka propozuar gjykatës që të aprovoje në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e detyruar të paditurën t'ia bëjë kompensimin e lartcekur.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigje në padi ka theksuar se lidhur me pretendimet e paditësit si në kërkesëpadi i kundërshton si të pa bazuara dhe të pa argumentuar me asnjë provë se e njëjta është anëtar i sindikatës, por edhe nëse do të ishte anëtarë e sindikatës, e njëjta me asnjë provë nuk ka dëshmuar se ka dorëzuar kërkesën drejtuar Ministrisë së Financave lidhur me mundësin e sigurimit të mjeteve financiare, që e cila në fakt nuk ekziston ndonjë përgjigje lidhur me mundësinë buxhetore të punëdhënësit ( mendimi juridik Gj Supreme). Lidhur me zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale (KKS) me nr.prot. OS-38.. e datës 12.06.20.., duhet të kundërshtohet padia dhe kërkesëpadija për arsye se koha e pensionimit të znj.M.Rr është data 23.03.20.., në të cilën periudhë nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e cila ka hyrë në fuqi me 12.06.20.., dhe si institucion nuk kemi pasur baze ligjore për zbatim. Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 12.06.20.. e lidhur në mes të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ka qenë në fuqi në periudhën kohore tri (3) vjeçare

dhe përkatësisht nga data 11.06.20.. e deri me date 10.06.20.. e cila kontrate është shkëputur me date 21.11.20.. nga Ministria e Shëndetësisë, dhe nenit 90 paragrafi 4 te Ligjit Nr. 03/L

-212 i Punës përcakton se Marrëveshja Kolektive mund te lidhet për një periudhe te caktuar me kohëzgjatje jo me shume se tri (3) vjet. Andaj, saj përket pretendimit të paditëses e cila pretendon se Mendimin Juridik i Gjykatës Supreme Nr.212/2023 i datës 09.10.2023, të gjejë zbatueshmëri edhe ne sektorin e shëndetësisë, e paditura thekson se kjo nuk qëndron për faktin ne mendimin juridik është cekur se-citoj: Objekt i këtij mendimi juridik është çështja e pagës se 13-të, dhe kushtet që duhet plotësuar për të fituar shpërblim sipas Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.20... Që në fakt këto kushte nuk janë plotësuar sepse kontrata kolektive që thekson paditësja e njëjta nuk është në fuqi nga dt. 11.06.20.., ashtu siç theksohet dhe në mendimin juridik. Andaj e paditura qëndron pran deklarimeve te theksuara si me lartë te argumentuara me prova, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*-Kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e PABAZUAR.*

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, e ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestues këto fakte: se paditësja ishte në marrëdhënie pune tek e paditura, gjë që është vërtetuar përmes Kantatës se Punës Nr.prtok. 212/0 të datës 31.12.2012 me kohe te pacaktuar duke filluar nga data 01.01.2013; po ashtu fakti se e njëjta ishte pensionuar për shkak të arritjes së moshës ligjore 65 vjeçare, dhe nga Vendimi i te paditurës me

nr.902 të datës 07.07.20.. gjykata ka konstatuar se paditësja deri ne vitin 2015 ka pasur 45 vite e 3 muaj përvoje pune.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte baza juridike e kërkesëpadisë se paditëses pasi që e paditura pretendon se nuk është e obliguar të kompensoj paditësen lidhur me shpërblimin e pagave për përcjellje në pension dhe shpërblimin jubilar duke u bazuar ne faktin se kërkesa është parashtruar jashtë afatit kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e vitit 2015 ishte në fuqi, dhe para afatit kur Kontrate Kolektive Sektoriale ka hyre në fuqi.

Sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. Nga Njoftimi i Odes Ekonomike te Kosovës datës 15.09.2017, vërtetohet se Oda Ekonomike e Kosovës si palë nënshkruese është tërhequr nga zbatimi i Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive të Kosovës, njoftim i dhënë brenda afatit prej 3 muaj para skadimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, konform nenit 81 paragrafi 1 të MPKK-së, andaj zbatimi i kësaj marrëveshje ka përfunduar pas kalimit të afatit tre (3) vjeçar të hyrjes së saj në fuqi, dhe kjo nënkupton se kjo marrëveshje është aplikuar në përdhën kohore nga data 01.01.20.. deri me datën 31.12.20...

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe nga provat të cila gjendën në shkresat e lëndës, rezultoi se kërkesëpadia e paditëses është paraqitur pas afatit kohor brenda të cilës ka vepruar Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës. Kjo pasi që paditësja ka paraqitur padi në gjykatë për shpërblimin e pagave për përcjellje në pension dhe shpërblimin jubilar për shkak se e njëjta ka dal ne pension me datën 23.03.2018, mirëpo Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi nga 01.01.2015 dhe e cila ka pasur vlefshmëri për një afat tre (3) vjeçar, pra ka pasur shtrirje kohore të zbatimit deri me datë 31.12.20.. (neni 82 i MPKK-së).

Gjithashtu gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke u bazuar edhe në Mendimin Juridike nr.xx/2023 të datës 27.02.20.. të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përcaktohet "Në praktikë është paraqitur si dilemë, dhe në disa raste janë zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, duke theksuar se e njëjta duhet të aplikohet nga data 01.01.2015- 31.12.2018, me arsyetimin se nga kjo marrëveshje asnjëra palë nënshkruese nuk është tërhequr në afatin e paraparë prej tre muajve para skadimit, duku iu referuar nenit 81 paragraf 1, me të cilin përcaktohet se: "Nga MPKK, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo

MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës ". Në paragraf 2 të këtij neni, përcaktohet se: " Nëse nga MPKK, pasi që skadon afati i përcaktuar nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit". Për Gjykatën Supreme të Kosovës, një përfundim i tillë është i gabuar, pasi Oda Ekonomike e Kosovës, si nënshkruese e kësaj marrëveshje, me njoftimin për tërheqje nga marrëveshja, i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës, më datë 09.11.2017, me nr. protokolli 01-49., i cili njoftim është publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës, më datë 13.11.2017, dhe nga kjo rezulton se tërheqja është bërë në afatin e paraparë me nenin 81 paragrafi I dhe 2, të marrëveshjes në fjalë dhe se e njëjta nuk ka vlefshmëri pas kalimit të afatit për të cilin është lidhur, pra pas datës 31.12.2017, për arsye se: fjalia e përdorur në nenin 81 paragraf I, ku përcaktohet se: " Nga MPKK palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese ", është fjali e dy kuptimshme, pasi nuk është e qartë nëse ka të bëjë me periudhën tre muaj para skadimit apo është fjala për tre muajt e fundit deri në skadimin e marrëveshjes, dhe nëse e marrim për bazë edhe formulimin "Nëse nga MPKK, pasi që skadon afati i përcaktuar..." në paragrafin 2, kjo dykuptimësi edhe më shumë shtohet dhe bëhet më e paqartë pasi nuk është e qartë se i referohet afatit të skadimit sipas paragrafit 1 , të këtij neni, apo i referohet skadimit të afatit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, andaj në këtë rast bazuar në dispozitën e nenit 85, dhe 87, të Ligjit Nr. 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me të cilën përcaktohet se: "Dispozitat e paqarta në kontratën pa shpërblim duhet interpretuar në kuptimin që dispozita e rëndon më pak debitorin, ndërsa te kontrata me shpërblim në kuptimin me të cilin realizohet një marrëdhënie e drejtë e prestimeve reciproke". Në këtë rast konkret Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, për nga natyra e saj në raport me punëdhënësit, është se krijon vetëm detyrime për të cilat nuk ka kundër shpërblim nga të punësuarit në raport me obligimet e krijuara nga kjo marrëveshje, andaj edhe duhet konsideruar se në rastin konkret me vetë faktin se Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje, me njoftim është tërhequr nga marrëveshja, nuk ka mundur të zbatohet neni 81 paragrafi 2, i kësaj marrëveshje".

Po ashtu gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses nuk ka bazë ligjore as në Kontratën Kolektive Sektoriale (KKS) me nr.prot. OS-38.. e datës 12.06.20.., duke u nisur nga fakti se koha e pensionimit të paditëses është me date 23.03.20.., ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur ne mes te Federatës se Sindikatave te Shëndetësisë se Kosovës dhe Ministrisë se Shëndetësisë, ka qene ne fuqi ne periudhën kohore tri (3) vjeçare dhe përkatësisht nga data 11.06.2018 e deri me date 10.06.20.. e cila kontrate është shkëputur me date 21.11.20..

nga Ministria e Shëndetësisë, andaj rezulton se kërkesëpadia e paditëses është paraqitur para afatit kohor brenda të cilës ka vepruar Kontrate Kolektive Sektoriale.

Rrjedhimisht, Gjykata ka vërtetuar se padia e paditëses e paraqitur me datë 22.03.20.. është paraqitur pas skadimit të Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe para hyrjes në fuqi të Kontrate Kolektive Sektoriale, andaj të njëjtat nuk mund të aplikohen dhe nuk mund të paraqesin bazë ligjore për kërkesëpadinë e paditëses, pasi që në kohën e pensionit të paditëses as Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe as Kontrate Kolektive Sektoriale nuk kanë qenë në fuqi.

Andaj, bazuar në këtë Gjykata gjeti si të bazuara pretendimin e përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha provat dhe pretendimet e parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse kryesisht në arsyetimin e vendimit, i'u referuar provave që kishin ndikim vendimtar në vendosje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta, gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 450 të LPK-së, pasi që i autorizuari i palës së paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE P....  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:053651, C.nr.445/21, Dt.12.11.2024

Gj y q t a r i  
Vegim Maloku

---

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.